

Ftesë për grantet e Fondit Konkurrues për Hortikulturë 2012

Në vitin 2012, projekti Promovimi i Hortikulturës në Kosovë, i implementuar nga Helvetas Swiss Intercooperation, përsëri do të ofrojë grantet e FKH për projekte të cilat sigurojnë përfitime për sektorët e hortikulturës dhe të bujqësisë në Kosovë. Projektet duhet të ndihmojnë në rritjen e punësimit dhe të ardhurave për këto sektorë.

Më poshtë është një përmbledhje e kritereve kryesore për grantet e FKH. Ju lutemi drejtohuni webfaqes të shënuar në fund të këtij dokumenti për kritere më të detajuara.

Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit

- Projektet duhet të jenë të zbatueshme në aspektin komercial dhe të tregojnë potencialin për rritjen e të ardhurave dhe punësimit në sektorin e agrobiznesit
- Projektet duhet të jenë të drejtuara nga sektori privat (ndërmarrës individualë, kompani dhe shoqata) dhe të mbulojnë një mundësi të qartë në treg.
- Do të preferohen projektet në sektorët e hortikulturës që mbështeten nga aktivitetet e PHK, por gjithashtu do të konsiderohen edhe projekte nga aktivitetet e pas-vjeljes ose inovacione nga nën-sektorë të tjerë të bujqësisë
- Aplikuesit duhet të jenë në gjendje të përfundojnë projektet deri në fund të muajit Maj 2012.

Kategoritë për Projekt-propozime:

Propozimet do të ndahen në 3 kategori, dhe aplikacioni duhet të shpjegojë qartësisht se cilës kategori i përket:

1. Prodhimtaria:

Do të merren në konsideratë projektet në sektorin e pemëve dhe perimeve të cilat e rrisin shkallën komerciale të prodhimit për fermerët ekzistues. Kjo kategori kufizohet sa më poshtë:

- Serrat me teknologji moderne me sipërfaqe më të madhe se 20 ari (2,000 metra katrore)
- Përmirësime në infrastrukturën e pemishteve, si sisteme kundër breshrit, për pemishte të cilat janë në prodhimtari, dhe të cilat përdorin teknologji moderne dhe me sipërfaqe më të madhe se 1 hektar.

- Nuk do të ofrohen grantet për kostot direkte në prodhimtari, si për fidanë të pemëve ose perimeve ose për shpenzime të inuteve (plehra, pesticide etj.).
 - Projektet nuk duhet të mbështeten nga skema të tjera grantesh
2. Investimet në aktivitetet e pas-vjeljes si klasifikimi, përpunimi, deponimi dhe aktivitetet e marketingut në sektorin e agrobiznesit.
3. Idetë inovative për përmirësimin e konkurrencës nga bizneset ekzistuese në sektorin e hortikulturës.
- Investimet në përmirësimet e infrastrukturës që kanë lidhje me komunitetet lokale mund të mbështeten nëse menaxhohen dhe drejtohen nga sektori privat.

Fondet:

- Buxheti i FKH do të jetë i gatshëm për vetëm një raund grantesh në vitin 2012
- Bashkë-investimi maksimal nga PHK është në masën 50% të buxhetit të pranueshëm të projektit.
- Minimumi i granteve do të jetë 10,000 Euro
- Gratë dhe minoritetet inkurajohen të aplikojnë për grantet e FKH.
- Grantet ofrohen në formë kompensimi (rimbursim) ndaj shpenzimeve, në kohën kur projektet janë plotësisht të implementuara dhe të gjitha pagesat janë kryer nga përfituesi i grantit.

Procedurat dhe Afatet Kohore:

- Letrat e konceptit në shqip, serbisht ose anglisht duhet të dorëzohen në formatin e gatshëm i cili mund të shkarkohet nga webfaqja e PHK-se www.helvetas-ks.org/HPK/en/cfh.html dhe të dorëzohen deri të Premten me 27 Janar, 2012
- Aplikacionet duhet të dorëzohen nëpërmjet email-it ose të dorëzohen në Zyrën e Helvetas Swiss Intercooperation.
- Të gjitha pyetjet duhet t'i drejtohen Zyrtarit të Projektit për FKH nëpërmjet email-it, cfh.rks@helvetas.org ose kosovo.info@helvetas.org ose përmes tel **038 517 715 lok. 110** ose **044 880 842** çdo ditë pune nga ora 14.30 deri 16.30



Informacioni Kontaktues

Email-i: cfh.rks@helvetas.org, kosovo.info@helvetas.org
Adresa: Rr. Nazim Gafurri Nr. 33, (Kati 3),
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Webfaqja: www.helvetas-ks.org/HPK/en/cfh.html

Projekti i financuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

MINISTRY OF FOREIGN
AFFAIRS DENMARK



Projekti i implementuar nga:



HELVETAS
Swiss Intercooperation

KOSOVO